

U botua dt 6 mars 2012 ne gazeten Telegraf dhe NOA News of Albania

APEL DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, AMBASADORIT TE BE , OSBE DHE SHBA TË AKREDITUAR NË SHQIPËRI

Zotëri të nderuar,

Ne, Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve "Pronësi me Drejtësi prej 20 vjetësh jemi në kuftë pa kompromis për të demaskuar qëndrimin e papërgjegjshëm të drejtuesve të politikës ndaj të drejtës së qytetarëve për të gëzuar pronën e tyre të treshëguar.

Për ta bërë produktiv mundimin tuaj për të mirën e popullit dhe të demokracisë dhe për ti vënë fre kleptokracisë dhe humbjes së jetëve të tjera njerëzore nga radhët e popullit dhe që të hiqen pengesat artificiale për statusin në BE, jam i detyruar të ripërsëris disa fakte të publikuara nga "Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar".

Ky Komitet, në raportin e 22 shkurt 2010, "Për kulturën e ligjit dhe shtetin e së drejtës përballë krimeve kundër jetës" thekson se "mëse 50 % e popullsisë në fshat mbetet e konfliktuar deri në ekstrem për titujt e pronësive, dhe më tej ve në dukje se "në komunën Bushat janë 1050 familje në konflikt për token". Ndërsa ekspedita dy mujore e „Misionarëve të pajtitimit“ me 20 Mars 2011 i ka raportuar zyrtarisht BE, OSBE/ODIHR, etj se : „Ekspedita konstatoi se numri i personave që janë vrarë me vetegjyqesi në 21 vjet të tranzicionit për token, pronat, nderin, grindjet e çastit dhe konfrontimet politike është 10,070. Vrasjet vetëm për pronën e tokat janë mbi 6000. 80 % e vrasjeve për tokën dhe pronën janë shkaktuar nga ligji përkatës i miratuar me konsensus nga dy partitë kryesore parlamentare. Numri i njerezve që sot janë të fshehur e të ngujuar për shkak të gjakmarrjes është 5500". Nuk ka pasur asnjë veprim konkret për këtë gjendje katastrofike, ku politikanët me anarkinë e titujve të pronësisë po e mbajnënë konfliktualitet të vazhdueshëm popullin shqiptar.

Lidhur me anarkinë e pronës, personalisht, ju kam derguar me datë 18.06.2011 , një kërkesë që të ushtroni ndikimin tuaj në mënyrë që -zgjidhja e problemit të pronësisë të jetë prioritet mbi prioritetet për klasën politike shqiptare për vendosjen e demokracisë dhe luftën kundër korrupsionit politik dhe ekonomik-por përsi pozicioni juaj ka vazhduar me formulën vëzhgimit se si po plotësohen 12 kërkesat e raportit të mbajtur prej z. Stefan Fyle.

Në letrën publike që i kam drejtuar ambasadorit të BE z. Etoze Sequi që është botuar me datë 22.12.2011 me dhimbje them se : "zyrtarët e lartë të Bashkimit European: Baronessa Catherine Ashton, z. Stefan Fyle, ambasadorët dhe drejtorët e Bankës Botërore, FMN dhe USAID, krahas lidërshiptit politik shqiptar mbajnë përgjegjësi për jetët e humbura nga vrasjet për shkak të pronës. Nëse ndërkombëtarët do vazhdojnë vetëm të ndjekin me vëmendje progresin e mardhënies PD-PS, kodin zgjedhor etj, populli do vazhdojë të jetojë dhe të vuajë në gërmadhën e komunizmit. Demokracia për popullin do të vijë më shpejt vetëm nëpërmjet kushtëzimit përfshi edhe të fondeve që ndërkombëtarët japin për Shqipërinë. Kushtëzimi duhet të përcaktojë afate të shpejta që politikanët ti japin

fund talljes me parimet themelore të demokracisë dhe qëndrimit të deritanishëm që ka lejuar shkeljen e të drejtës së pronës së trashëguar.”

Së fundmi Qeveria së bashku me Ministrinë e Bujqësisë, Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjisë e Informacionit dhe të Komunikimit i ka propozuar Kuvendit të Shqipërisë një projektligj për ndryshimin e ligjit 8053 dt 21.12.1995. Formalisht hartuesit e projektligjit pretendojnë që shteti plotëson detyrimin që ka marrë përkundrejt këtyre subjekteve, me miratimin e VKM nr. 452, datë 17.10.1992. Kjo do të thotë që meqenëse kemi gabuar me pronën do vazhdomë me konsekuencë në drejtimin e gabuar. E gjithë procedura për hartimin e këtij projektligji është bërë, pa asnjë konsultim me Shoqatën Pronësi me Drejtësi dhe Shoqatën Bregdeti që përfaqësojmë palën e dëmtuar.

Ne APELOJME deputetët që të reflektojnë në betimin e tyre për zbatimin e Kushtetutës, duke e kthyer këtë projektligj si antikushtetues pasi vetë VKM nr 451 dt 17.10.1992 dhe VKM nr. 161, datë 8.4.1993, janë pa bazë juridike, ndajnë për frymë në persona të tretë tokën që grabiti komunizmi dhe që duhet ti ktheset pronarit të ligjshëm. Ky projektligj bie ndesh me vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gj. Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese. Pas 20 vjet nuk duhet të vazhdohet me ligje që mohojnë plotësisht të drejtën e pronësisë dhe detyrimet kushtetuese. Zgjidhja është e thjeshtë nëse do të respektohet e drejta e pronësisë sipas detyrimeve kushtetuese.

Me respekt

Rrapo Hajredin Danushi

Kryetar i Shoqatës Kombëtare të Shoqatës

“Pronësi me Drejtësi”